



RREGULLAT E ASAMBLESË SË GJYQTARËVE TË EULEX-it

Neni 1

Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it

Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it është themeluar si një organ vetëqeverisës. Kjo asamble përbëhet nga të gjithë gjyqtarët e caktuar për ushtrimin e funksionit gjyqësor dhe për monitorimin, udhëzimin dhe këshillimin në pajtim me modalitetet e përcaktuara nga Misioni i EULEX-it në Kosovë.

Asambleja është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha çështjeve që lidhen me administrimin dhe punën e Gjyqtarëve të EULEX-it sipas ligjit, këtyre rregullave dhe të Misionit të EULEX-it në Kosovë.

Gjatë kryerjes së funksionit të tyre gjyqësor, Gjyqtarët e EULEX-it duhet të jenë të pavarur duke u bazuar në standardet më të mira evropiane dhe në parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e njeriut.

Asambleja dhe Kryetari i saj janë kujdestarë dhe mbrojtës të pavarësisë së gjyqësorit.

Përveç kësaj, Asambleja është përgjegjëse:

- për të vendosur mbi çdo kërkesë për përjashtimin e Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, kur ajo ose ai kryen funksionin e Gjyqtarit të lëndës dhe kërkesa për përjashtim është paraqitur nga njëra nga palët;
- për të zgjedhur me votim të fshehtë gjyqtarët të cilët do të përbëjnë kolegjin për përzgjedhjen e ardhshme të gjyqtarëve;
- për të zgjedhur me votim të fshehtë dy anëtarët e Bordit Disiplinor;
- për të vendosur mbi çdo ankesë rreth masës disiplinore;
- për të miratuar, me kërkesën e Kryetarit të Asamblesë, Rregullat mbi përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve, duke u mbështetur në kriteret e paracaktuara objektive dhe në masat mbrojtëse procedurale;
- për të raportuar rreth funksioneve të monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit;
- për të organizuar trajnimin e vazhdueshëm të Gjyqtarëve të EULEX-it.

Asambleja duhet të jetë një forum i hapur për shkëmbimin e përvojave, zgjidhjeve dhe praktikave më të mira.

Neni 2

Kryetari

Kryetari i Asamblesë thërret, përgatit rendin e ditës dhe kryeson seancat e Asamblesë si dhe ushtron këto funksione të përcaktuara me ligjin, me këto rregulla dhe me Misionin e EULEX-it në Kosovë.

EULEX Kosovo

Presidency of the Assembly
of the EULEX Judges
Supreme Court of Kosovo
Luan Haradinaj street
Police Avenue
P.O. Box: 268, 10000
Pristina, Kosovo
www.eulex-kosovo.eu,
info@eupt-kosovo.eu



Neni 3

Nënkryetari

Kryetari mund të emërojë një Nënkryetar që mund ta zëvendësojë Kryetarin në rast të mungesës apo paaftësisë së tij, i cili i kryen funksionet e përcaktuara me këto Rregulla dhe ato të deleguara nga Kryetari.

Anëtari më i vjetër i asamblesë për nga mosha, kryeson asamblenë në rast të mungesës apo paaftësisë së Nënkryetarit, po qe se Kryetari konsideron se mbledhja nuk duhet të shtyhet.

Neni 4

Bordi i Kryesisë

Bordi i kryesisë themelohet për ta mbështetur Kryetarin në aktivitetet e tij të menaxhimit të Asamblesë, të menaxhimit të gjykatës, të përzgjedhjes së lëndëve dhe të caktimit të lëndëve.

Bordi përbëhet nga shtatë anëtarë përveç Kryetarit dhe Nënkryetarit, Personave kontaktues të secilës Gjykatë të Qarkut, Personit kontaktues të Gjykatës Supreme, dhe Kryetarit të Dhomave të Posaçme. Po ashtu, në cilësinë e vëzhguesit ftohet edhe Përfaqësuesi i Gjyqtarëve të kolegjit për ankesa lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me AKP-në.

Në raste urgjente, Bordi mund ta këshillojë Kryetarin.

Bordi miraton vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit, të cilët janë të pranishëm në takim (5 nga gjithsej 9 anëtarë).

Kryetari apo, në mungesë të tij, Nënkryetari mund të marrin vendime të jashtëzakonshme, nëse vonesa do të shkaktoje dëm ose paragjykim.

Çdo vendim i tillë i jashtëzakonshëm duhet të raportohet në asamblenë e radhës, e cila thirret brenda 15 ditësh nga miratimi i masave urgjente, kur ato të jenë të rëndësishme.

Procesverbali i mbledhjes së Bordit të kryesisë mbahet nga Sekretaria e Asamblesë. Sekretaria mban dhe ruan procesverbalet në arkiv, ashtu që anëtarët e asamblesë t'iu referohen atyre në të ardhmen.

Neni 5

Sekretaria e Asamblesë

Sekretaria e Asamblesë duhet të përbëhet nga Sekretari i emëruar nga Kryetari, Asistenti ligjor i Kryetarit dhe Zyrtari ndërlidhës për çështjet që kanë të bëjnë me drejtësinë. Sekretaria ndihmon mbledhjet e Bordit të Kryesisë dhe të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it. Sekretaria përgatit materialet përkatëse dhe dokumentet që lidhen me menaxhimin dhe funksionimin e Bordit të kryesisë dhe të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, harton procesverbalet e mbledhjeve të tyre dhe siguron ekzekutimin e vendimeve të tyre.

EULEX Kosovo

Presidency of the Assembly
of the EULEX Judges
Supreme Court of Kosovo
Luan Haradinaj street
Police Avenue
P.O. Box: 268, 10000
Pristina, Kosovo
www.eulex-kosovo.eu,
info@eupt-kosovo.eu

Kryetari përcakton funksionet e tjera të Sekretarisë.

Neni 6

Mbledhjet e Asamblesë

Asambleja thirret së paku një herë në çdo tre muaj. Me propozimin e gjashtë anëtarëve të Asamblesë, Kryetari i Asamblesë thërret Asamblenë brenda tetëmbëdhjetë ditësh nga pranimi i propozimit.

Asambleja mbahet me rend në secilën zonë të Gjykatave të Qarkut. Anëtarët e Asamblesë duhet të pranojnë thirrjet dhe rendin e ditës së Asamblesë së paku njëzet ditë para datës së caktuar për seancë. Pika e parë e rendit të ditës çdoherë duhet të jetë vendimi i Asamblesë për procesverbalin e seancës së kaluar.

Çdo anëtar ka të drejtë të fusë një pikë në rendin e ditës, jo më vonë sesa pesëmbëdhjetë ditë para mbajtjes së seancës. Anëtarët duhet të pranojnë rendin përfundimtar të ditës së paku dhjetë ditë para seancës.

Në parim, mbledhjet e Asamblesë nuk janë publike. Asambleja, eventualisht, mund të ftojë persona fizikë apo juridikë në cilësinë e ekspertëve, mysafirëve apo në ndonjë cilësi tjetër, të cilën Asambleja e konsideron të nevojshme.

Neni 7

Këshillimet

Asambleja si një organ këshillues ka forum, po qe se 2/3 e anëtarëve të saj janë të pranishëm.

Këshillimet miratohen me vota të hapura me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast të propozimeve të kundërta, vota miratohet përmes votimit. Ai propozim i cili merr shumicën e votave miratohet.

Në rast se nuk ka shumicë të qartë, Kryetari hedh votën e tij vendimtare.

Vendimet e Asamblesë hyjnë në fuqi menjëherë, nëse nuk parashihet ndryshe.

Asambleja zgjedh përmes votimit të fshehtë gjyqtarët të cilët do të jenë pjesë e kolegjit për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe të Bordit disiplinor.

Diskutimet sa më të hollësishme dhe kërkimi i konsensusit të përgjithshëm do të ishte i mirëseardhur.

Neni 8

Zgjidhjet

Asambleja mund të merr përsipër çdo zgjidhje e cila është e rëndësishme për ushtrimin e funksioneve të saja.

EULEX Kosovo



Neni 9

Komisionet dhe komitetet

Asambleja mund të formojë grupe punuese me qëllim të studimit të pyetjeve komplekse dhe të përgatitjes së propozimeve për Asamblenë.

Asambleja mund të formojë komitete për t'u marrë me çështje specifike. Komitetet dhe grupet punuese duhet të mbështeten dhe të bashkërendohen nga Sekretaria.

Neni 10

Bërja publike e vendimeve

Vendimet e Asamblesë janë publike. Asambleja mund të vendosë që një vendim të mbahet i fshehtë për shkaqe të sigurisë, të mbrojtjes së një sekreti profesional, mbrojtjes së fshehtësisë së jetës private të gjyqtarëve apo të palëve të treta.

Neni 11

Ndryshimi i këtyre rregullave

Ndryshimet e këtyre rregullave mund të propozohen nga ana e Kryetarit dhe Nënkyetarit të Asamblesë, nga ana e Bordit të kryesisë dhe nga 6 anëtarë të Asamblesë.

Këto rregulla janë ndryshuar në Asamblenë e 6-të me radhë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur më 17 qershor 2009 në Mitrovicë

Maria Giuliana Civinini,

Kryetare e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

EULEX Kosovo

Presidency of the Assembly
of the EULEX Judges
Supreme Court of Kosovo
Luan Haradinaj street
Police Avenue
P.O. Box: 268, 10000
Pristina, Kosovo
www.eulex-kosovo.eu,
info@eupt-kosovo.eu